



Ministry of Foreign Affairs
and International Cooperation



AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO



CIHEAM
IAM BARI



MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL



PROGRAMI PËR MODERNIZIMIN E BUJQËSISË (PROMAS)

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Shqipëri

Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I SEKTORIT TË ULLIRIT NË SHQIPËRI – ASDO



P. Pasko

CIHEAM Bari

MBI KULTIVARËT AUTOKTONË TË ULLIRIT

KULTIVARËT E ULLIRIT NË SHQIPËRI

- Bazuar kryesisht në botimet: *Kultura e ullirit* (N. Kafazi, Dh. Muço 1971), *Resurset Gjenetike të Ullirit* (Dh. Panajoti 2008), *Resurset shqiptare të ullirit*, *Kultura e ullirit dhe Përmirësimi i popullatës varietale të ullirit* (H. Ismaili 2012, 2018, 2019) -

Kultivarët autoktonë, ashtu si në vende të tjera të Pellgun Mesdhetar, nuk janë thjesht varietete apo kultivarë të pastër, por popullata me variabilitet të gjerë gjenetik, shumë shpesh të përzgjedhura me mënyra empirike nga bujqit brez pas brezi.

Ruajtja dhe studimi i resurseve gjenetike janë të domosdoshëm nga një anë për të shpëtuar pasurinë gjenetike dhe nga ana tjetër për të kryer përmirësim gjenetik të kultivarëve më të rëndësishëm nëpërmjet metodave klasike (seleksionim klonal, kryqëzime, etj.) dhe sidomos me metoda moderne gjenetiko molekulare.

Prania e ullishteve të vjetra dhe jetëgjatësia e kësaj bime bëjnë që rreziku i zhdukjes së resurseve gjenetike ose erozioni gjenetik në ulli të jetë më i pakët se në speciet e tjera.

Objektivat e studimit të resurseve gjenetike janë :

1. Identifikimi i diversitetit gjenetik në ullishtet tona **(DHJETRA ARTIKUJ SHKENCORË E STUDIME TË KRYERA)**
2. Studimi i karakteristikave biologjike dhe agronomike **(STUDIME NË KOLEKSIONE EX SITU DHE IN SIU, KATALOG I KULTIVARËVE AUTOKTONË BOTUAR NGA INSTITUTI I RESURSEVE GJENETIKE BIMORE DHE ENTI I FARËRAVE DHE FIDANAVE)**
3. Krijimi i një banke të dhënash për të ndihmuar studimet për përmirësimin gjenetik të materialit bimor

Vlera të gjermoplazmës autoktone

Vlera pozitive për t'u shfrytëzuar në përmirësimin e strukturave varietore dhe si material bazë në përmirësimin gjenetik janë:

- **Cilësitë e mira organoleptike të frutit dhe të vajit**
- **Qëndrueshmëria dhe stabiliteti i përvitshëm i prodhimit**
- **Qëndrueshmëria e lartë ndaj faktorëve të stresit biotik dhe abiotik**
- **Hershmëria në pjekje**
- **Periudha e zgjatur e pjekjes dhe e konsumit**

Skema pomologjike e përgatitur për studimin e gjermoplazmës autoktone ka lejuar identifikimin dhe stabilizimin e sinonimeve të materialit të lokalizuar.

Bazuar në shkallën e rëndësisë dhe përhapjen, **kultivarët autoktonë të ullirit në Shqipëri** klasifikohen në **kryesorë** dhe **dytësorë**.

“Kultivarët kryesorë” kultivohen në sipërfaqe të mëdha dhe zotërojnë shumë zona.

“Kultivarët dytësorë” nuk kanë numër zotërues në rajonin e vet por janë bazë e disa ullishteve.

Gjashtë janë kultivarët kryesorë autoktonë, të cilët që përfaqësojnë gjashtë zonat e lashta të kultivimit të ullirit: 'Kalinjot' (Vlorë), 'Kokërmadh Berati' (Berat), 'Mixan' (Elbasan), 'Ulliri i Bardhë i Tiranës' (Tiranë), 'Krypsi i Krujës' (Krujë) dhe 'Kallmet' (Lezhë).



1. Zona e Kalinjotit: Vlorë, Cakran, Mallakastër, Gjirokastër, Sarandë e Delvinë.

Kultivarë të dytë: Pulazeqini, Ulliri i hollë i Himarës, Nisioti dhe Ulliri i Kuq i Damësit

2. Zona e Kokërmadh të Beratit: Berat, Fier, Lushnjë.

Kultivarë të dytë: Marksi e Kotruvsi, Ulliri i bardhë.

3. Zona e Mixanit: malësitë e Peqinit, Elbasan, Godolesh.

Kultivarë të dytë: Kokërmadh Elbasani.

4. Zona e Ullirit të Bardhë të Tiranës: Tiranë, Durrës.

Kultivarë të dytë: Boçi, Ulliri i Zi, Ulliri i Kuq, Karren, Kusha.

5. Zona e Krypsit të Krujës: Krujë.

Kultivarë të dytë: Ulliri i bardhë i Krujës, Managjel, Frëngu.

6. Zona e Kallmetit: Lezhë, Shkodër.



Kultivarë të dytë: Ulliri i bardhë i Lezhës, Ulliri i butë.






Kultivari 'Kalinjot' është i vetmi që kultivohet jashtë zonës së tij

*Veçori të kryesore të disa
kultivarëve autoktonë të ullirit*




Kultivarë me përdorim të dyfishtë (1)

Kultivari	Sinonime	Origjina, përhapja dhe disa tipare kryesore
<p data-bbox="40 211 117 254">Boç</p> 	<p data-bbox="253 211 446 368">Gjykatës, Kupac, Krypës</p>	<p data-bbox="484 211 1885 596">Kultivar autokton i zonës së Tiranës, i shpërndarë në ullishtet e kësaj zone. I pa përhapur jashtë vatrës së tij të origjinë. Bimë jo shumë e zhvilluar me tendencë për të shkuar lart. Pjekje e shkallëzuar dhe mesatarisht e vonë e prodhim mesatarisht periodik. Fryt i madh, 4,31 g me përmbajtje mesatare vaji (21-22%). Aftësi rrënjëzimi mesatare. Shumë i ndjeshëm ndaj <i>Syrit të palloit</i>, i ndjeshëm ndaj <i>Mizës së ullirit</i>. I qëndrueshëm ndaj të ftohtit, thatësirës dhe ndaj gëlqeres në tokë.</p>
<p data-bbox="40 635 214 792">Kalinjot ose Kaninjot</p> 	<p data-bbox="253 635 349 735">Ulli i butë</p>	<p data-bbox="484 635 1885 906">Kultivar autokton i zonës së Vlorës me emërtim nga fshati Kaninë. I përzgjedhur prej shekujsh, përbën një popullatë me ndryshueshmëri morfologjike, ku dallohen forma me kurorë globoze dhe vertikale, të cilat projekti aktual ASDO i përcaktoi si dy kultivarë të ndryshëm dhe këshilloi prodhimin e fidanave me emërtime të veçanta.</p> <p data-bbox="484 921 1885 1306">Bimë e zhvilluar, pjesërisht autofertil, i përhapur gati në gjithë Shqipërinë, ka dalë jashtë zonës së origjinës, ku përbën rreth 80 % të ullishteve i shoqëruar më tepër nga olivastrat dhe kultivari <i>Pulazeqin</i>. Cilësi e lartë vaji, (26-28% vaj). Fryti 3,64 g, piqet në nëntor-dhjetor. Aftësi e lartë rrënjëzimi. I ndjeshëm ndaj <i>Mizës së ullirit</i>, <i>Syrit të Palloit</i> dhe <i>Kancerit bakterial</i>. I qëndrueshëm ndaj të ftohtit dhe thatësirës. Hyn në prodhim pas mbjelljes - relativisht vonë.</p> <p data-bbox="484 1320 1885 1416">Studjuesi H. Ismaili (2019) ka raportuar 6 klone me përmirësime të dukëshme në madhësinë e frytit dhe përmbajtjen e vajit.</p>




Kultivarë me përdorim të dyfishtë (2)

Kultivari	Sinonime	Origjina, përhapja dhe disa tipare kryesore
<p data-bbox="54 219 185 258">Marks</p> 	<p data-bbox="285 219 471 258">Ulliri vajs</p>	<p data-bbox="575 219 1870 544">Kultivar autokton në zonën kodrinore Berat - Fier - Mallakastër, i shpërndarë dhe i rrallë nëpër ullishte. Autofertil, prodhim kostant, pjekje mesatarisht e vonë, e njëkohëshme. Fryt 3,07 g me përmbajtje vaji 21-23%. Tolerant ndaj <i>Cycloconium oleaginum</i>, i ndjeshëm <i>Bractocera oleae</i>. I qëndrueshëm ndaj të ftohtit. Aftësi mesatare rrënjëzimi.</p>
<p data-bbox="54 581 243 619">Managjel</p> 	<p data-bbox="285 581 484 619">Ulli kalaje</p>	<p data-bbox="575 581 1850 905">Kultivar autokton në zonën e Krujës, i shpërndarë, popullatë e pa përpunuar nga seleksionimi. Nuk ka dalë nga vatra e origjinës. Autosteril, pjekje e vonë dhe e njëkohëshme, prodhim periodik, përmbajtje vaji 20-22%. Fryti 3,51 g. I qëndrueshëm ndaj të ftohtit, ndaj <i>Cycloconium</i> e <i>Pseudomonas</i>, i ndjeshëm ndaj <i>Bractocera oleae</i> dhe <i>Gleosporium olivarum</i>.</p>
<p data-bbox="54 942 214 981">Kallmet</p> 	<p data-bbox="285 942 517 981">Kokërmadh</p>	<p data-bbox="575 942 1875 1323">Kultivar autokton me origjinë nga fshati Kallmeti i Lezhës. Mbizotëron në zonën e vet (41.4 %), i përhapur edhe në Shkodër. Autosteril, me pjekje mesatare (vjeshtë) e të njëkohëshme. Futet herët në prodhim, i cili është konstant. Fryt 3,7g e përmbajtje mesatare vaji (20%). I ndjeshëm ndaj <i>Cycloconium</i>, <i>Bractocera oleae</i> dhe <i>Gleosporium olivarum</i>; tolerant ndaj <i>Pseudomonas</i>., i qëndrueshëm ndaj të ftohtit dhe gëlqeres.</p>




Kultivarë për vaj (1)

Kultivari	Sinonime	Origjina dhe përhapja
<p>Ulliri i Bardhë i Krujës</p> 		<p>Kultivar autokton i zonës së Krujës dhe përbën rreth 17 % të ullishtes së zonës. Nuk është i përhapur jashtë kësaj vatre. Autofertil e me pjekje të vonë (dhjetior e të shkallëzuar. Fryti 2,6 g, me 25-26% vaj. Prodhim periodik. I ndjeshëm ndaj <i>Cyclonium</i> dhe i qëndrueshëm ndaj <i>Bractocera olea</i>, ndaj të ftohtit, thatësirës dhe gëlqeres në tokë. Ka aftësi rrrënjëzuese mesatarisht të lartë.</p>
<p>Ulliri i Bardhë i Tiranës</p> 	<p>Qumështo-re</p>	<p>Kultivar autokton i zonës së Tiranës me rëndësi ekonomike, mbasi përbën pjesën kryesore të ullishtes. Duke qënë se vatra e tij e origjinës është e gjërë , ky kultivar përbën një popullatë me ndryshueshmëri dhe vlera të larta cilësore. Nuk është i përhapur jashtë vatrës së tij . Në nënzona të ndryshme ka edhe emërtime të ndryshme. Autofertil 25-28% vaj cil. Sh. e mirë, aftësi rrrënjëzimi – e lartë. Shumë i ndjeshëm ndaj Syrit të palloit dhe i qëndrueshëm ndaj Mizës së ullirit, ndaj të ftohtit, thatësirës dhe gëlqeres në tokë.</p> <p>Studjuesi H. Ismaili (2019) ka raportuar 6 klone me përmirësime të dukëshme në madhësinë e frytit dhe përmbajtjen e vajit.</p>
<p>Ulliri i bardhë i Pobratit</p> 		<p>Mund të jetë me origjinë nga vatra e Ullirit të bardhë të Tiranës. Ky kultivar ose ekotip nuk është përmëndur në literaturën e mëparshme. Gjëndet në zonën e Donofrosës dhe Pobratit duke zënë rreth 50-60 % të kësaj ullishteje me emrin „ulliri i bardhë“</p>





Kultivarë për vaj (2)

Kultivari	Sinonime	Origjina dhe përhapja
<p>Frëngu</p> 		<p>Emërtimi mund të shkaktojë konfuzion për origjinën e këtij kultivari. Ullishte shekullore me këtë kultivar ekzistojnë në zonat kodrinore midis Tiranës dhe Krujës me vatër në Qinam. Është me lokalizim të ngushtë dhe nuk është i përhapur jashtë zonës së vet. Fryti 2,12 g, me pjekje të vonë, e përmbajtje vaji 24-26% , me cilësi shumë të mirë. I ndjeshëm ndaj Syrit të Palloit dhe Mizës së ullirit, i qëndrueshëm ndaj Tuberkulozit, të ftohtit dhe thatësirës. Aftësi e lartë rrënjëzimi.</p>
<p>Kusha</p> 	<p>Kushan</p>	<p>Kultivar autokton në zonën Tiranë (origjina nga Preza), Durrës, Fushë Krujë. I lokalizuar dhe jo i përhapur jashtë kësaj zone, përbën një popullatë me tre foma , të cilat dallohen për nga madhësia e frytit. Pjesërisht autofertil. Fryti 2,23 g, me pjekje të vonë; përmbajtje vaji 22-24% me cilësi mesatare. Preket pak nga Syri i Palloit, shkon mirë në toka kodrinore të thata, i qëndrueshëm ndaj të ftohtit. Ka aftësi të lartë rrënjëzimi.</p>
<p>Mixan</p> 	<p>Bixaj Vajsi i Peqinit Mixa</p>	<p>Kultivar autokton. Origjina mund të jetë nga fshati Bixaj dhe zona përreth tij. Ullishte shekullore në fshatrat Pajovë e Bishqem të Peqinit. Pjesërisht autofertil, fryti 2,3 g, me përmbajtje vaji 25-28% me cilësi shumë të lartë. Pjekje e vonë e shkallëzuar, mjaft i qëndrueshëm ndaj thatësirës dhe të ftohtit, i përshtatshëm për toka të varfra. I ndjeshëm ndaj Syrit të Palloit dhe Mizës së ullirit, i qëndrueshëm ndaj Tuberkulozit. Ka aftësi të lartë rrënjëzimi</p>




Kultivarë për vaj (3)

Kultivari	Sinonime	Origjina dhe përhapja
<p>Kotruvs</p> 		<p>Kultivar autokton në zonën e Beratit ku përbën rreth 14 % të pemëve, i përhapur edhe në zonën e Fierit dhe Mallakastrës . Autofertil me pjekje të njëkohshme të mesme - të vonë, me prodhimtari të lartë e të rregullt. Fryti 2,46 g, me 24-25% vaj të cilësisë së mirë. I përshtatur ndaj tokave të varfra dhe i qëndrueshëm ndaj temperaturave të larta, të ftohtit. Dhe thatësirës. I ndjeshëm ndaj Syrit të Palloit dhe Mizës së ullirit. I qëndrueshëm ndaj Tuberkulozit. Aftësi rrënjëzimi mesatare.</p>
<p>Ulliri i hollë i Himarës</p> 	<p>Nisiot</p>	<p>I lokalizuar në fshatin Vuno dhe Himarë. Emërtimi ka origjinë nga forma e zgjatur dhe e hollë e frutit. Shumë prodhues dhe i ndryshëm nga Nisioti i Mallakastrës. Autofertil, me pjekje të hershme dhe rëzim të madh të frutave në pjekje. Fryti 1,56 g, me përmbajtje vaji 17-18% me cilësi shumë të mirë. I qëndrueshëm ndaj Syrit të Palloit, ndaj thatësisë së gjatë verore. Ka prekje të hershme nga Miza e ullirit.. Aftësi e ulët rrënjëzimi. Studjuesi H. Ismaili (2019) ka raportuar 3 klone me përmirësime të dukëshme në madhësinë e frytit dhe përmbajtjen e vajt.</p>
<p>Ulliri i Zi</p> 		<p>Kultivar autokton i zonës së Tiranës dhe Durrësit Nuk është i rëndësishëm për nga numri i ullinjve. Është bashkëshoqërues në këto ullishte me Ullirin e bardhë të Tiranës , Boçin, olivastrat etj. Aitosteril. Me pjekje të mesme të vonë, të njëkohshme. Fryti 2,82 g, me përmbajtje vaji 17-20%, me cilësi mesatare. I qëndrueshëm ndaj të ftohtit, thatësisë, Syrit të Palloit, tolerant ndaj Tuberkulozit, i ndjeshëm ndaj Mizës së ullirit. Aftësi rrënjëzimi mesatare.</p>

Kultivarë për vaj (4)

Kultivari	Sinonime	Origjina dhe përhapja
<p>Unafka</p> 		<p>Anon më tepër nga ullastrat. Eshtë bashkëshoqerues me Kokërmadhin e Beratit ku përbën një numur të pa rëndësishëm në këto ullishte, por polenizues i mirë i tij. Autosteril, me pjekje të hershme të shkallëzuar. Fryti 1,69 g me përmbajtje vaji 15 %. I qëndrueshëm ndaj Syrit të Palloit, Mizës së ullirit, ndaj të ftohtit dhe thatësisë. I qëndrueshëm edhe ndaj gëlqeres në tokë. Aftësi e ulët rrënjëzimi.</p>
<p>Nisiot</p> 		<p>Kultivar i përhapur në zonën e Mallakastrës (Greshicë, Fratar, Kutë etj) ku përbën rreth 50 % të ullinjve. Nuk gjëndet në zona të tjera. Autosteril, me pjekje të mesme të shkallëzuar. Fryti 2,29 g, me përmbajtje vaji 20-22% me cilësi të mirë. Prodhim periodik. Pak i ndjeshëm ndaj syrit të Palloit, por dëmtohet nga temperaturat e ulta dhe tuberkulozi. Aftësi mesatare rrënjëzimi.</p>
<p>Ulliri i Kuq</p> 		<p>Kultivar autokton me origjinë nga zona e Ndroqit dhe Durrësit, i përhapur okalizuar në këtë zonë. Ndodhet i shpërndarë në ullishtet e kësaj zone. Autofertil, me pjekje të vonë e prodhim konstant. Fryti 2,1 g me përmbajtje vaji 22%. I qëndrueshëm ndaj Syrit të Palloit dhe Mizës së ullirit, i ndjeshëm ndaj Mizës së ullirit. I qëndrueshëm ndaj të ftohtit dhe thatësisë . Ka aftësi të lartë rrënjëzimi.</p>
<p>Pulazeqin</p> 		<p>Kultivar popullatë e ullishteve shekullore në zonën e Vlorës ku përbën rreth 5 % të pemëve, i përhapur në Himarë, Delviinë e Cakran. Vetësteril. Prodhim i hershëm, i njëkohshëm. Fryti 1,92 g, përmbajtje vaji 17-18%. I qëndrueshëm ndaj Syrit të Palloit, i ndjeshëm ndaj tuberkulozit dhe Mizës së ullirit. I qëndrueshëm ndaj të ftohtit dhe tokave gëlqerore. Aftësi e ulët rrënjëzimi.</p>

Kultivarë për tryezë (1)

Kultivari	Sinonime	Origjina dhe përhapja
<p>Kokërmadhi i Beratit</p> 	<p>Kokërmadh Vlonja</p>	<p>Kultivar i Beratit, kryesisht i ullishteve shekullore në zonën urbane, ku përbën rreth 72 % të pemëve. Dallohen dy forma kryesore me fryt të madh dhe me fryt mesatar. Shoqërohet me Unafkën për pjalmim të kryqëzuar. I përhapur në Lushnjë, Fier, Tiranë, por me efektiviteti jo të njëjtë, duke çfaqur edhe papërshtatëshmëri. Autosteril, me prodhimtari mesatare. Fryti 6,69 g, me përmbajtje vaji 18-21 % me cilësi të mirë. është ulliri më i mirë për tryezë. I ndjeshëm ndaj Syrit të palloit, Mizës së ullirit dhe tuberkulozit. Mesatarisht i qëndrueshëm ndaj të ftohtit dhe thatësisë. Aftësi rrënjëzimi e ulët.</p> <p>Studjuesi H. Ismaili (2019) ka raportuar 4 klone me përmirësime të dukëshme në madhësinë e frytit dhe përmbajtjen e vajit.</p>
<p>Kokërmadh i Elbasanit</p> 		<p>Kultivar autokton i ullishteve shekullore afër zonës urbane të Elbasanit, ku përbën 51 % të pemëve. Shoqërohet gjithnjë me ullastrat e ndryshme e më pak me Mixanin. Nuk është i përhapur jashtë kësaj zone. Vetësteril me prodhim mesatar. Fryti 3,7 g me përmbajtje vaji 22 %. I ndjeshëm ndaj Mizës së ullirit dhe kushteve të mjedisit. Aftësi mesatare rrënjëzimi.</p>
<p>Krypsi i Krujës</p> 		<p>Kultivar autokton i Krujës, ku ze rreth 70 % në ullishtet shekullore rreth qytetit. Nuk është i përhapur jashtë kësaj zone. Vetësteril, me pjekje të mesme të njëkohshme e prodhimtari të lartë. Fryti 3,8 g, me përmbajtje vaji 23-24%. Cilësi fryti shumë e lartë, i qëndrueshëm gjatë transportit. I qëndrueshëm ndaj të ftohtit, i ndjeshëm ndaj Syrit të Palloit dhe Mizës së ullirit. Aftësi e madhe rrënjëzimi.</p> <p>Studjuesi H. Ismaili (2019) ka raportuar 2 klone me përmirësime të dukëshme në madhësinë e frytit dhe përmbajtjen e vajit.</p>

KOLEKSIONET *ex situ* DHE *in situ*
TË ULLIRIT NË SHQIPËRI –
TË DHËNA PËRMBLEDHËSE



SHËNIM

Të dhënat në slaidet vijuese i përgjigjen zonës dhe kohës së regjistrimit të tyre; është e nevojshme që ato të pasurohen me të dhëna nga zona të tjera të vendit dhe për kultivarë të tjerë, edhe në kuadër të ndryshimeve klimatike në këto 15 vitet e fundit.

KOLEKSIONE TË HERSHME DHE AKTUALE TË AKSESIONEVE TË ULLIRIT

Koleksioni i Institutit të Bankës Gjenetike (Valias-Tiranë – UBT): krijuar në vitin 2010 me 60 aksesione me synim për të arritur në 100 kultivarë autoktonë dhe të huaj

Koleksioni i Ullirit Shamogjin – QTTB Vlorë - krijuar në vitin 1972 me 44 kultivarë, rikonstruktuar në vitin 1995 me 60 kultivarë të huaja me 4 pemë homologe për çdo aksesion

Koleksioni i Ullirit Lukovë – Shën Vasil (Krekëz) - krijuar në vitin 1984 në Shën Vasil (Krekëz), me 46 kultivarë autoktonë dhe të huaj.

Stacioni i shumëzimit Pus Mezini – krijuar në vitin 1987 me 82 genotipe me 2 pemë homologe.

DISA TË DHËNA PËRMBLEDHËSE NGA KOLEKSIONET *EX SITU* TË ULLIRIT (1)

Koleksioni i Ullirit Lukovë – Shën Vasil (Krekëz) (të dhëna vitet '70-80)

Koha e pjekjes:

cv Amfisa, Gordales, Kalamon, Manzanilla, Amigdanolia piqen herët, mund të vilen që në tetor, ndërsa *cv. Picual* - në fund të nëntorit
Cv. Koroneiki, Cunatis, Cucurela piqen vonë, vjelje në dhjetor-janar

Prodhimi

Cv Koroneiki, Picual, Cunatis, Manzanilla dhe *Kukurela* kanë dhënë prodhime të larta dhe të përvitshme.

cv Kalamon ka shfaqur prodhimtari të parregullt

Përmbajtja e vajit

Janë shquar *cv Cunatis - 35.13%, Cucurela 24%* dhe *Koroneiki 22-24%*

Në bazë të koeficientit të periodicitetit këshillohet përhapja e *cv. Koroneiki, Cunatis, Kukurela, Pikual dhe Manzanilla*

DISA TË DHËNA PËRMBLEDHËSE NGA KOLEKSIONET *EX SITU* TË ULLIRIT(2)

Koleksioni i Ullirit Shamogjin – QTTB Vlorë (të dhëna 1988-1992)

Koha e pjekjes:

cv S Katerina, Lecino, Frantoio, Karboncela, Leucocarpa, Koratina, Pulazeqin dhe Amphisa kanë pjekje të hershme (vjeshtë e mesme)

cv. Fraxhivento, Ascolana, Grosso di Spania, Itrana, Picual, Gordal, Manzanilla kanë pjekje të mesme (nëntor)

cv. Kalinjot, I holli i Himares dhe Boci kanë pjekje të vonë (dhjetor)

Prodhimi

Cv. Frantoio, Lecino, Pulazeqin dhe Franxhivento kane dhënë prodhim të lartë dhe të përvitshëm

Përmbajtja e vajit

Janë shquar *cv. Kaninjot 27%, I Bardhi i Tiranës 26%, Karen 25%, dhe Frantoio 24%.*

Në bazë të koeficientit të periodicitetit këshillohet përhapja e *cv. Manzanilla, Franxhivento, Lecino dhe Frantoio*

DISA TË DHËNA PËRMBLEDHËSE NGA KOLEKSIONET *EX SITU* TË ULLIRIT(3)

Koleksioni i Ullirit Vlorë (të dhëna 1992 - 2005)

3 grupime të mëdha në bazë të koeficientit të periodicitetit:

1. Kultivarë me koeficient periodiciteti (0.09-0.30) - *Lecino, Manzanilla, Amigdanolia, Koroneki, Pulazeqin, Cunatis* dhe *Ulliri i zi i Tiranës (klon)*.

2. Kultivarë me koeficient periodiciteti (0.30-0.45) - *Pikual, Ulliri i kuq i Tiranës, Mastoidis, Lukova-3, Ascolana, Leucocarpa, Koratina, Karboncela, Kotruvsi, Mixan, Nivica 1, Kokërmadhi i Beratit, Kalinjot (klon), I Bardhi i Tiranës, Frëng, I hollu i Himarës, Kushan*.

3. Kultivarë me koeficien periodiciteti mbi 0.45 kanë rezultuar të gjithë kultivarët të cilët nuk janë përfshirë në dy grupimet e mësipërme.

DISA TË DHËNA PËRMBLEDHËSE NGA KOLEKSIONET *EX SITU* TË ULLIRIT(4)

Përfundime për cilësinë e vajit

Disa ekzemplarë të kultivarëve kryesorë të analizuar – *I holli i Himares, Kushan, Frëng, Mixan, Kalinjot* - të cilët ruhen në parcela private, shquhen jo vetëm për përmbajtje të lartë vaji, por edhe për cilësi superiore në bazë të nivelit të komponentëve të tretshëm, aromatizues, si terpenet - nga 300-700 mg/kg, klorofila 0-10 ppm, që jep ngjyrë dhe antioksidante, ester-arome dhe fenole - me veti antioksidante.

KOLEKSIONE *IN SITU* TË BIMËVE TË ULLIRIT NË SHQIPËRI

- Në shumë zona materiali bimor spontan **me vlera prodhuese dhe si nënshartesa** - ruhet material i çmuar për punë seleksionuese (madje pyje me ullishte 'të egra' ende të pastudiuara si duhet - zona të cilat për momentin janë jashtë rrezikut të afërm të zhdukjes për shkak të largësisë nga zonat e banuara)
- me politika bujqësore të veçanta mund të stimulohen produktet e ullishtave 'të egra' si prodhime organike, me treg të zgjedhur
- Prej vitesh studjues individualë ose që punojnë në grupe, kanë përcaktuar bimë ulliri të veçanta me cilësi superiore, nëpër ullishte, të cilat janë në ruajtje dhe në përgjithësi të listuara prej tyre dhe objekt studimi.

Mungon ende një listim zyrtar i gjithë bimëve të ullirit në ruajtje *in situ*.

Fryt i një pune të dedikuar shumëvjeçare në koleksione *in situ* dhe *ex situ*, e në baza të posaçme shumëzimi është edhe krijimi i kloneve për 5 kultivarë të rëndësishëm, raportuar nga Prof. Dr. H. Ismaili (2019)

Objektivat kryesore të këtij seleksionimi kanë qenë gjetja e individëve:

- me konstante prodhimi që luhatet nga 0,0-0,20
- me përqindje vaji 1,5-2% më të lartë se standardi varietal
- me kalibër fryti me peshë mbi 0,2 gram më të lartë se standardi varietal

kultivari	Nr. i kloneve	shënim		
		periodiciteti	Fryti g. (max)	% vaji (max)
Ulliri i Bardhë i Tiranës	6	0,56 → 0,23-0,30	2,12 → 2,44	25 → 27,5
Kokërmadhi i Beratit	4	0,55 → 0,25-0,20	6,0 → 7,1	17 → 20,9
I holl i Himarës	3	0,56 → 0,20-0,27	1,1 → 2,44	17 → 20,5
Krypsi i Krujës	2	0,56 → 0,17-0,26	3,6 → 4,01	20 → 23
Kalinjot	6	0,56 → 0,10-0,27	3,6 → 4,2	26 → 29,1

Klonet e mësipërm nuk janë regjistruar ende në Regjistrin e posaçëm të Institutit të Bankës Gjenetike (UBT), për t'u përfshirë në skemat e prodhimit të fidanave pasi t'u nënshtrohen procedurave të nevojshme dhe vlerësimit gjenetik e fitosanitar të tyre si 'bimë primare'.

Struktura e kutivarëve të ullinjve

Të dhëna mbi strukturën e kultivarëve të ullinjve në Shqipëri (1)

Deri më 2009 *Kalinjoti* dhe *Kokërmadhi i Beratit* përbënin përkatësisht 48% dhe 17 % të strukturës varietore, të ndjekur nga Frantoio me 10 %.


Mbas vitit 2010 kjo strukturë është ndryshuar në favor të kultivarëve ndërkombëtarë.

Ndër arësyet e rritjes së kërkesave për kultivarë të huaj kanë qenë:

- uniformiteti i kultivarit
- hershmëria e prodhimit
- mungesa e periodicitetit
- cilësia e prodhimit
- mungesa e një udhëzuesi mbi përshtatjen e kultivarëve të huaj dhe të vendit në zona të ndryshme (kërkesë urgjente për mbjelljet e reja dhe strukturën e prodhimit të fidanishteve)

Të dhëna të Entit të Farërave për vitin 2016 për prodhmin e fidanave në vend

(23,2 % autoktonë e 76,8 % të huaj)



Përveç suksesit në rritjen e sipërfaqes së ullishteve në Shqipëri, në rreth 12-13 milion rrënjë, mungon vlerësimi i rimbjelljeve të kryera (reth 2-3 milion rrënjë), për shkaqe të ndryshme, si vijon:

- **Mospërputhje e kultivarit (vendas ose i huaj) me kushtet pedo-klimatike të zonës apo mikrozonës**
- **Mbjellja në zona të reja ku nuk ka pasur përvojë në kultivimin e ullirit (p.sh. Belsh) ose në fushë (Fier, Durrës, Lezhë, etj.)**
- **Mungesa e përputhjes së teknologjisë me kërkesat e veçanta të kultivarit**
- **Mosmarrja parasysh e kulturave paraardhëse, p.sh. Solanore, që lidhet me përhapjen e verticiliozës**
- **Kushte lagështie të lartë ajrore në pjesën fundore të luginave të mbjella me ullishte të reja – arsye për infeksione të larta nga Syri i palloit (p.sh. në Mallakastër)**

**Drejt një programi kombëtar
për përmirësimin gjenetik të
ullirit**

Drejt një programi kombëtar për Përmirësimin gjenetik të ullirit (1)

Gjendja aktuale

- Kultivarët shqiptarë janë kryesisht popullata shekullore ku mungon seleksionimi, pra uniformiteti
- Kultivarët tanë nuk janë të përshtatur ndaj kultivimit intensiv
- Karakteristikat cilësore nuk janë gjithnjë optimale
- Prodhimi i fidanave bazohet në material bimor të disa **ullishtave mëmë** në QTTB Vlorë dhe në disa fidanishte private, të cilat nuk mbulojnë të gjithë kultivarët autoktonë
- Raportimi për **21 klone të seleksionuara për 5 kultivarë kryesorë autoktonë** përbën një hap të rëndësishëm përpara, i cili duhet të konkretizohet më tej dhe të kalojë vlerësimet gjenetike dhe fitosanitare për t'u përdorur si burime primare dhe të shtrihet edhe në kultivarë të tjerë.

Drejt një programi kombëtar për Përmirësimin gjenetik të ullirit (2)

Vështirësi

- Periudhë e gjatë deri në hyrje në prodhim të plotë (10-15 vjet)
- Mungesa e njohurive mbi trashëgiminë e tipareve kryesore agronomike dhe e përvojës për përdorimin e teknikave moderne
- Mungesa e një bërthame të kualifikuar për përmirësimin gjenetik të ullirit në shkallë vendi

Mundësi

- *Konstatimi i variabilitetit të gjerë në germoplazmën shqiptare përbën një bazë me vlera të mëdha, por që duhet të thellohet edhe më tej, sidomos në drejtim të:*
 - bashkëpunimit gjenotip X mjedis
 - njohjes së thelluar të arkitekturës gjenetike të materialit bazë

Drejt një programi kombëtar për Përmirësimin gjentik të ullirit (3)

Konsiderata

Në bilancin e kryer në Itali për ecurinë e programit të përmirësimit gjenetik të ullirit në dhjetvjeçarët e fundit, u konstatua se *metodat klasike të përmirësimit gjenetik si seleksionimi klonal, mutagjeneza artificiale dhe seleksionimi masiv nuk kanë dhënë rezultatet e dëshiruara* dhe se është e nevojshme të kalohet në programe kryqëzimi të programuara, të bazuara në metodën e 'gene pools' (bagazhin e gjeneve), duke përdorur gjerësisht teknikat bioteknologjike e molekulare.

Drejt një programi kombëtar për Përmirësimin gjenetik të ullirit (4)

Disa Objektiva specifike të përmirësimit gjenetik të ullirit

- **Hershmëri prodhimi (me të cilën konkurojnë mjaft kultivarë të huaj)**
- **Prodhim i vazhduar (pa periodicitet)**
- **Përmbajtje e lartë vaji**
- **Cilësi e lartë vaji (p.sh. përmbajtja e acidit oleik)**
- **Qëndrueshmëri ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve**
- **Qëndrueshmëri ndaj streseve pedo-klimatike**
- **Përshtatje ndaj vjeljes mekanike**

Drejt një programi kombëtar për Përmirësimin gjenetik të ullirit (5)

Disa aspekte të mbështetjes për programin kombëtar:

- ***Iventarizim i gjithë resurseve gjenetike si metodë për vlerësimin e diversitetit***
- ***ngritje e ekipeve të specialistëve për ndjekjen periodike dhe konstante të erozionit gjenetik***
- ***trajnim i specialistëve shqiptarë dhe bashkëpunim me institucione të specializuara të huaja***
- ***sigurim i pajisjeve laboratorike për vlerësimin e diversitetit***
- ***vlerësim i çdo aksesion për vlera bujqësore, për krijimin e peisazheve, etj.***
- ***hartimi i një strategjie kombëtare të mbështetur në ligj, përfshirë përballimin e kostove financiare***



Ministry of Foreign Affairs
and International Cooperation



AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO



CIHEAM
IAM BARI



MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL



PROGRAMI PËR MODERNIZIMIN E BUJQËSISË (PROMAS)

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Shqipëri

Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I SEKTORIT TË ULLIRIT NË SHQIPËRI – ASDO



P. Pasko

CIHEAM Bari

PROGRAMME FOR THE MODERNIZATION OF THE AGRICULTURAL SECTOR (PROMAS)

Ministry of Agriculture and Rural Development, Albania

Italian Agency for Development Cooperation

SUSTAINABLE DEVELOPMENT OF THE OLIVE SECTOR IN ALBANIA – ASDO

MBI KULTIVARËT AUTOKTONË TË ULLIRIT